

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6250
E premte, 26 shkurt 2021
çmimi 0.40 €

KIPRED-i me raport:
Mediat serbe dhe ruse
prodhuan mijëra lajme të
rreme për Kosovën | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NJË HARTË NË ZYRËN E EMISARIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR DIALOGUN
KOSOVË - SERBI, MIROSLAV LAJÇAK, E CILA TREGON KOSOVËN PJESË INTEGRALE
E SERBISË, KA NXITUR REAGIME TË SHUMTA NË KOSOVË | FAQE 4-5

FOTOGRAFIA E LAJÇAKUT ME HARTËN E SERBISË DHE KOSOVA PJESË E SAJ, NXITË REAGIME TË SHUMTA

Për Bashkimin Evropian (BE) mbajtja e hartave që tregojnë Kosovën pjesë integrale e Serbisë është normale. Një hartë të tillë e mban edhe ndërmjetësi i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, e cila ka shkaktuar reagime të shumta në Kosovë. BE-ja ka vazhduar ta mbrojë këtë hartë duke dhënë arsytim për këtë çështje. Zëdhënësi i BE-së për Politikë të Jashtme, Peter Stano, ka thënë se harta është në linjë me pozicionin neutral të BE-së ndaj statusit të Kosovës. Një veprim i tillë është vlerësuar si gafë e emisarit special të BE-së e cila tregon anshmërinë e tij



PËR RASTIN PËR KEQPËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE KËRKOHEM PARABURGIM PËR 11 PERSONA | FAQE 7



Prokuroria Themelore ka kërkuar të enjten paraburgimin e 11 personave, pas dyshimeve për marrje dhe dhënie ryshfeti, keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe për dhënie të ndihmës për kryerjen e veprave penale. Masa e paraburgimit është kërkuar për personat e ndaluar pas një aksioni të Policisë së Kosovës më 24 shkurt në komunat Prishtinë, Podujevë, Gjiilan, Istog dhe Lipjan

SULMOHET FIZIKISHT GAZETARI VISAR DURIQI | FAQE 7



OPINION

PA E DITUR ASKUSH,
KADARE BËHET AMBASADORI
I PARË I MADH
I ÇËSHTJES SË KOSOVËS | F. 11

Bedri
ISLAMI



AKTUALE



BIDENI PËRMBYS VENDIMIN E
TRUMPIT PËR NDALESA NDAJ
IMIGRANTËVE | F. 2

NË 24 ORËT E FUNDIT, PESË
VIKTIMA DHE 437 RASTE TË
REJA ME COVID NË KOSOVË | F. 3

VDES ISH-USHTARI UÇK-së,
AFRIM ALIJAJ | F. 6

EKONOMI

FKGK-ja SQARON PROCEDURAT
PËR PËRFITIMIN E BIZNESEVE
NGA RIMËKËMBJA EKONOMIKE | F. 9

KOSTT-I NËNSHKRUAN
MARRËVESHJE ME SOLAR
ENERGY EUROPE | F. 9



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

I nominuari për udhëheqje të CIA-s e sheh Kinën si “kundërshtare autoritare”

WASHINGTON, 25 SHKURT - William Burns, i nominuari i presidentit amerikan Joe Biden për ta udhëhequr Agjencinë Qendrore të Inteligjencës (CIA), u ka thënë ligjvënësve më 24 shkurt se “testi më i madh gjeopolitik” për Shtetet e Bashkuara vjen nga Kina, mirëpo ka deklaruar se edhe Rusia përbën kërcënim.

Burns, ish-ambasador në Rusi dhe Jordan, i ka bërë këto deklarata gjatë seancës së konfirmimit të tij në këtë pozitë, para Komitetit të Senatit për Inteligjencë.

Ai e ka quajtur Kinën “të frikshme dhe kundërshtare autoritare”, që është duke rritur

fuqinë për ta vjedhur pronën intelektuale, për t'i shtypur njerëzit e saj dhe për të ndërtuar ndikim brenda Shteteve të Bashkuara. Megjithatë, ai ka thënë se mund të ketë hapësirë për bashkëpunim me Pekinin, në fushat si ndryshimet klimatike dhe mospërhapja e armëve bërthamore.

Ai ka thënë se Rusia vazhdon të përbëjë kërcënim potencial, ndonëse në disa aspekte është duke i rënë fuqia botërore. “Për aq kohë sa Vladimir Putini është lider i Rusisë, ne do të veprojmë në një fushë të ngushtë të mundësive kundrejt konkurrencës së ashpër të

kundërshtarit”, ka thënë ai. Sipas tij, sulmet e fundit kibernetike në departamentet e qeverisë amerikane, mbrapa të cilave besohet se është Rusia, shpërfaqin rreziqet e nënvlerësimit të Kremlinit dhe shërbejnë si thirrje “e ashpër zgjimi” për dobësitë e zinxhirëve të infrastrukturës kritike.

Ai ka thënë se administrata Biden do të hartojë së shpejti një raport për të vlerësuar raportet me Rusinë, përfshirë hakimin. Autoritetet ruse kanë hedhur poshtë përfshirjen në këtë incident.

Burns, 64-vjeçar, pritet ta fitojë



konfirmimin dhe të bëhet diplomati i parë i karrierës që drejton CIA-n. Ai është konfirmuar nga Senati pesë herë

në të kaluarën, për punën e tij ambasador në Jordan, Rusi dhe tri pozita të larta të Departamentin e Shtetit.

Bideni përmbys vendimin e Trumpit për ndalesa ndaj imigrantëve

WASHINGTON, 25 SHKURT - Presidenti amerikan Joe Biden ka përmbysur një vendim të ish-presidentit Donald Trump për t'i bllokuar aplikuesit e lejeve të qëndrimit (green card), që të hyjnë në Shtetet e Bashkuara.

Trump pati bërë këtë ndalesë vitin e kaluar, duke thënë se është e nevojshme që të mbrohen punëtorët amerikanë në kohën e papunësisë së lartë, të nxitur nga koronavirusi. Kjo ndalesë ishte planifikuar të zgjaste deri në fund të vitit 2020, mirëpo Trumpi e ka zgjatur atë deri në fund të marsit, në ditët e fundit sa ka qenë në pushtet.



Shumica e vizave të imigrantëve janë bllokuar me këtë urdhër, bazuar në deklaratat e avokatëve për imigrim. Imigrantët nuk kanë mundur t'i marrin familjarët e tyre, përveç nëse ata kanë qenë shtetas amerikanë, që kanë aplikuar për viza për bashkëshortët apo fëmijët nën moshën 21-vjeçare. Imigrantët me viza pune, po ashtu, nuk kanë mundur të shkojnë në ShBA gjatë kësaj kohe, përveç nëse kanë pasur aftësi në fushën e kujdesit shëndetësor dhe profesione të tilla të ngjashme. Sipas vendimit të ri të 24 shkurtit, Bideni ka pezulluar këto

vendime, duke thënë se mbyllja e dyerve për imigrantët e ligjshëm “nuk është në interes të Shteteve të Bashkuara”. Ai ka kundërshtuar pretendimet e Trumpit se imigrantët mund ta dëmtojnë tregun e punës, duke thënë se urdhrat u kanë pamundësuar familjeve që të bashkohen, si dhe kanë dëmtuar bizneset amerikane. Biden, demokrat, është zotuar për të kthyer mbrapsht një mori politikash të Trumpit për t'ua ndaluar hyrjen banorëve të shteteve me shumicë myslimane.

Kokainë në vlerë miliarda eurosh konfiskohet në Evropë

BERLIN, 25 SHKURT - Autoritetet e doganave në Gjermani dhe Belgjikë kanë konfiskuar një rekord prej më shumë se 23 tonëve të kokainës që ka pasur destinacion Holandën. Zyrtarët gjermanë kanë zbuluar 16 tonë kokainë në pesë kontejnerë të transportit, të cilët kanë arritur në portin e Hamburgut nga Paraguai më herët gjatë këtij muaji. Policia në Holandë ka qenë e njoftuar edhe për 7.2 tonë shtesë të kokainës që janë

gjetur në portin belg të Antwerpit. Zyrtarët gjermanë kanë thënë se kokaina ka pasur çmim të tregut deri në miliarda euro. Një 28-vjeçar, i dyshuar për përfshirje në trafikim të drogës, është arrestuar në Holandë, ka thënë policia holandeze të mërkurën. Dy bastisjet, që kanë ndodhur më herët gjatë këtij muaji, kanë rezultuar me konfiskim të një sasive jashtëzakonisht të madhe të kokainës, kanë thënë zyrtarë

të doganave. Në Hamburg gjendet porti më i madh në Gjermani, dhe i treti për nga madhësia në Evropë. Paraguai, në anën tjetër, ka qenë për vite shtet transit kyç për drogë. Kokaina e pastër mund të ndahet dhe të përzihet me substanca të tjera për t'i rritur përfitimet kur të shitet në rrugë. Vitin e kaluar rreth 102 tonë kokainë janë zënë në rrugë për në Evropë.



“Facebook”-u bllokoi llogaritë e ushtrisë së Mianmarit

NJU-JORK, 25 SHKURT - Gjiganti “Facebook” ka bllokuar të gjitha llogaritë e mbetura, të lidhura me ushtrinë e Mianmarit (Birmanisë), duke cituar përdorimin e forcës vdekjeprurëse të ushtrisë

kundër protestuesve. Mianmari është përballur me trazira prej kur ushtria ka marrë pushtetin më 1 shkurt dhe ka ndaluar lideren e qeverisë civile, Aung San Suu Kyi dhe një pjesë të

udhëheqësisë së partisë që ajo drejton, pasi ushtria ka pretenduar se zgjedhjet e nëntorit të vitit të kaluar janë manipuluar. Ky vendim i rrjetit social, që ka nisur së zbatuari menjëherë,

përfshin ushtrinë dhe subjektet nën kontrollin e saj si në “Facebook”, po ashtu edhe në “Instagram”. Aty ndalohen edhe të gjitha “subjektet e lidhura me ushtrinë” që të reklamohen në këto platforma.



Prokuroria jep hollësi të reja lidhur me rastin 'Thesari'

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka dhënë hollësi të reja lidhur me rastin "Thesari". Sipas njoftimit nga Prokuroria, deri më tani lidhur me këtë rast janë arrestuar dy persona të cilët gjenden në paraburgim për veprat penale "Keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit" nga neni 414, paragrafi 2 dhe 3, pika 3.4, në lidhje me paragrafin 1 të KPRK-ës dhe "Shpëlarja e parave" nga neni 302 i KPRK-së, lidhur me veprën penale "Pastrimi i parave" nga neni 56 i Ligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. "Vlen të theksohet se deri më tani shuma e përgjithshme e ngrirë është rreth 600 000 euro, janë sekuestruar 4 automjete, vlera e përafërt e të cilave është 100 000 euro. Në proces të realizimit të kthimit të të

hollave të cilat janë tërhequr nga bankat komerciale në emër të realizimit të mbitërheqjeve, kredive etj., e të cilat kanë gjeneruar nga transferi i paligjshëm i realizuar nga ana e të pandehurve nga Thesari i Shtetit", ka njoftuar Prokuroria. Më tutje, theksohet se në kuadër të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar kanë bërë dy kërkesa adresuar autoriteteve të Republikës së Turqisë, lidhur me transferin prej 440.000 eurosh, të realizuara nga llogaria e LDA Group Sh.p.k, në pronësi të të pandehurit K.Sh, në llogarinë e një biznesi me seli në Republikën e Turqisë. "Është kërkuar ngrirja e llogarisë së identifikuar, është bërë identifikimi i bartësit/pronarit të llogarisë, personat e autorizuar, janë shikuar pasqyrat e transaksioneve", është thënë në njoftimin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.



Në 24 orët e fundit, pesë viktima dhe 437 raste të reja me Covid në Kosovë


Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka regjistruar të enjten 437 raste të reja me Covid-19 pas testimit të 2 643 mostrave në institucionet publike dhe ato private. Në 24 orët e fundit ky institut ka regjistruar edhe pesë viktima të diagnostikuara me sëmundjen Covid-19

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 SHKURT - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 2 643 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 437 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar

pesë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Deçan një rast (62 vjeç), Obiliq një rast (30 vjeç), Podujevë një rast (76 vjeç), Prishtinë një rast (82 vjeç) dhe Prizren një rast (77 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 67 906 raste nga 297 628 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 587 raste të të vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 255 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 59 174 raste, kurse numri i rasteve aktive është 7 145. Rastet pozitive janë nga



komunat: Prishtinë 194 raste, Prizren 36 raste, Pejë 34 raste, Vushtrri 21 raste, Gjakovë 20 raste, Ferizaj 18 raste, Mitrovicë 16 raste, Podujevë 16 raste, Gjilan 12 raste,

Lipjan 10 raste, Obiliq 8 raste, Viti 8 raste, Deçan 7 raste, Rahovec 6 raste, Fushë-Kosovë 5 raste, Kaçanik 4 raste, Suharekë 4 raste, Drenas 2 raste, Istog 2 raste,

Kamenicë 2 raste, Malishevë 2 raste, Shtime 2 raste, Skenderaj 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash, Hani i Elezit, Junik, Klinë, Klokot dhe Ranillug.

KQZ-ja vendos për rinumërim edhe të 58 vendvotimeve

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur që të rinumërohen edhe 58 vendvotime. Në mbledhjen e KQZ-së u tha të enjten se rinumërimi i 58 vendvotimeve të tjera vjen pasi nga verifikimi i bazës së të dhënave dhe krahasimit të votave të subjekteve dhe kandidatëve nuk janë shënuar votat për kandidatët. Ndryshe, nga java e kaluar deri tani KQZ-ja tri



herë ka votuar pro rinumërim. Fillimisht janë dërguar për rinumërim 12 vendvotime, pastaj

494 vendvotime të tjera dhe tash së fundi edhe 58 vendvotime. Në mbledhjen e KQZ-së, po ashtu,

u bë me dije se deri tani janë rinumëruar 220 vendvotime. Ndërkaq, pas debatit mes anëtarëve të KQZ-së për votimet në veri dhe përfaqësimin e komuniteteve në Kuvend, kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka lëshuar mbledhjen, duke kërkuar të mos diskutohet për çështje politike. "Bollni me cirkuz politik që po bëni në vazhdimësi. Çështjet politike diskutoni në parlament. Këtu nuk është parlament. Ne vetëm organizojmë zgjedhjet. Vazhdoni

fllisni para mediave", ka thënë Daka. Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës ka thënë se asnjëherë më parë nuk ka pasur kaq shumë raste të mbylljes së mbledhjeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve para kohe si rrjedhojë e përplasjeve politike. Cakolli ka theksuar se degradimi dhe shndërrimi i mbledhjeve të KQZ-së në hapësirë për shfryrjen e inateve politike, përmes devijimit nga agjenda, është për të ardhur keq.



NJË HARTË NË ZYRËN E EMISARIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI, MIROSLAV LAJÇAK, E CILA TREGON KOSOVËN PJESË INTEGRALË E SERBISË, KA NXITUR REAGIME TË SHUMTA NË KOSOVË

Fotografia e Lajçakut me hartën e Serbisë dhe Kosova pjesë e saj, nxitë reagime të shumta

Për Bashkimin Evropian (BE) mbajtja e hartave që tregojnë Kosovën pjesë integrale e Serbisë është normale. Një hartë të tillë e mban edhe ndërmjetësi i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, e cila ka shkaktuar reagime të shumta në Kosovë. BE-ja ka vazhduar ta mbrojë këtë hartë duke dhënë arsytim për këtë çështje. Zëdhënësi i BE-së për Politikë të Jashtme, Peter Stano, ka thënë se harta është në linjë me pozicionin neutral të BE-së ndaj statusit të Kosovës. Një veprim i tillë është vlerësuar si gafë e emisarit special të BE-së e cila tregon anshmërinë e tij

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 25 SHKURT - Një hartë që e tregon Kosovën pjesë integrale të Serbisë, e të cilën ndërmjetësuari i BE-së për dialog, Miroslav Lajçak, e mban në zyrë, ka nxitur reagime të

shumta në Kosovë. Një veprim i tillë në Kosovë është vlerësuar si mbajtje anë nga ndërmjetësuari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi.

Ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme, Meliza Haradinaj-Stublla, ka bërë me dije se i ka dërguar një hartë të saktë të

Ballkanit Perëndimor emisarit Lajçak.

Në llogarinë e saj në "Twitter", ajo ka shkruar sa më gjatë që zyrtari i BE-së e shmang hartën që ia ka bërë dhuratë, aq më gjatë puna e tij do të jetë dështim. "Hartat kanë rëndësi! Kuptova se ke nevojë për një

hartë të saktë të WB6 (gjashtëshes së Ballkanit Perëndimor), prandaj ta dërgova një me korrier diplomatik. Të punosh me harta të zombive është tërësisht joprofesionale, së këndejmi e mangët. Sa më gjatë që e shmang hartën që ta bëra dhuratë, aq më gjatë puna jote do të jetë dështim", ka shkruar Haradinaj-Stublla.

Edhe raportuesja e Parlamentit Evropian për Kosovën, Viola von Cramon, ka thënë se nuk do ta përdorte një hartë të tillë. Duke iu përgjigjur një përdoruesi në "Twitter", ajo ka thënë se një gjë e tillë nuk do ta ndihmonte procesin. "Nuk ndihmon. Nuk do ta përdorja një hartë të tillë, por kjo sigurisht nuk është zyra

ime", ka shkruar Von Cramon. Kritikta e shumta për një gjë të tillë nuk i kanë bërë përshtypje BE-së e cila e ka arsyetuar mbajtjen e kësaj harte në zyrën e emisarit Lajçak.

Zëdhënësi i BE-së për Politikë të Jashtme, Peter Stano, ka deklaruar se harta është një linjë me pozicionin neutral të BE-së ndaj statusit të Kosovës. Sipas tij, Kosova duhet të merret më shumë me dialogun dhe me problemet rreth tij. "Pretendimi rreth hartës është totalisht i pavend dhe i rremë. Kjo hartë zyrtare e BE-së është një linjë me pozicionin e BE-së - status neutral. Do të doja ta rekomandoja secilin që të fokusohet në problemet reale që

Prokuroria ngre aktakuzë kundër tre personave për dëbimin e shtetasve turq

Prishtinë, 25 shkurt - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër tre personave, nën dyshimet për "keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe privimit të kundërligjshëm të lirisë". Në një komunikatë për media, prokuroria ka dhënë vetëm inicialet e të pandehurve D. G., V. K. dhe Rr. S., por nuk ka saktësuar se për cilin rast bëhet fjalë.

Mediat vendore në Kosovë kanë publikuar emrat e plotë të të pandehurve, duke njoftuar se bëhet fjalë për Driton Gashin, ish-shef i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Valon Krasniqin, drejtor në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion në

Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe Rrahman Sylejmanin, drejtor i Drejtorisë për Migracion dhe të Huaj në kuadër të Policisë Kufitare në Kosovë. "Radio Evropa e Lirë" nuk i ka konfirmuar ende emrat e personave të përfshirë në aktakuzë.

Driton Gashi ishte shkarkuar nga detyra e shefit të AKI-së në prill të vitit 2018, nga ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, pas dëbimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova, në mars të po atij viti. Më 29 mars të vitit 2018, përmes një aksioni të gjerë të Policisë së Kosovës dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, në orët e hershme të mëngjesit u arrestuan gjashtë

shtetasit turq.

Dëbimi i tyre është thënë se është bërë përmes një aksioni të koordinuar ndërmjet shërbimeve të inteligjencës nga Turqia dhe Kosova. Ankaraja dyshon se ata janë anëtarë të organizatës "Hizmet", të udhëheqësit fetar turk Fetullah Gulen. Këtë të fundit, autoritetet turke e fajësojnë për një përpjekje për grushtshtet në Turqi në vitin 2016, kurse institucioni "Gulistan" konsiderohet i tij.

Pas arrestimit ata u dërguan në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", prej ku, duke shfrytëzuar një fluturim privat, u dërguan në Turqi. Pas mbërritjes atje, u përballën me një proces

gjyqësor, ku në fund u dënuan me 56 vjet dhe 7 muaj e gjysmë burgim.

Arrestimit dhe dëbimit i parapriu revokimi i lejeve të tyre të qëndrimit për të cilin veprim më vonë gjykata tha se ishte i jashtëligjshëm.

Nga pesë shtetasit turq, tre prej tyre posedonin leje të përhershme të qëndrimit, përkatësisht Mustafa Erdem, Yusuf Karabina, Karhaman Demirez, ndërsa dy prej tyre Hasan Hysein Demir dhe Cihan Ozkan kishin leje të përkohshme.

Familjet e gjashtë shtetasve turq ngritën një padi ndaj institucioneve të Kosovës në vitin 2018 për arrestim dhe ndalim arbitrar të familjarëve të

tyre.

Disa nga familjarët kanë kërkuar azil në Kosovë e disa të tjerë janë larguar drejt vendeve evropiane. Një nga të dënuarit në këtë rast është Hasan Gunakan, i cili u arrestua gabimisht në vend të Hasan Demir por, përkundër kësaj, ai u akuzua dhe u shpall fajtor nga një gjykatë në Turqi më 28 janar 2020.

Një komision i pavarur i Kuvendit të Kosovës konstatoi dhjetëra shkelje të ligjeve dhe konventave ndërkombëtare me rastin e deportimit të shtetasve turq.

Edhe një organ i OKB-së, pas një hetimi, konstatoi se institucionet e Kosovës shkelën të drejtat e shtetasve turq me rastin e deportimit.



ndihmojnë në avancimin e normalizimit të dialogut, në vend se të përpiqen të bëjnë raporte të rreme", ka shkruar Stano në një përgjigje në postimin në "Twitter" të gazetarit Adriatik Kelmendi, i cili ka shkruar se BE-ja duhet të kërkojë falje për këtë veprim. "Miroslav Lajçak duhet të kërkojë falje që dha intervistë derisa ishte ulur para një harte që paraqet Kosovën pjesë të Serbisë, përndryshe ai nuk duhet të mirëpritet nga askush në Kosovë të hënën", ka shkruar Kelmendi.

Përgjigjja e zëdhënësit të BE-së për Politikë të Jashtme ka nxitur reagimin e ish-kryenegociatores së Kosovës në dialogun me

Serbinë, Edita Tahiri. Në llogarinë e vet në "Twitter", ajo ka shkruar se për çfarë neutraliteti po flasin zyrtarët e BE-së, kur 22 shtete anëtare të saj e kanë njohur Kosovën shtet. "Shumica dërrmuese e vendeve anëtare të BE-së kanë njohur shtetin e pavarur të Kosovës. 22 e kanë njohur dhe vetëm 5 ende nuk e kanë njohur. Për çfarë lloji 'neutraliteti statusi' po flasin disa zyrtarë të BE-së?", ka shkruar Tahiri.

Për hartën në zyrën e ndërmjetësuesit të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi ka pasur edhe reagime nga vendorët dhe ndërkombëtarët.

Profesori universitar Blerim Latifi ka vlerësuar se një reagim i

tillë tregon se Lajçaku është pro serb. "Nëse na e kërkon Bashkimi Evropian, ne do ta shqyrtojmë vendimin për vendosjen e ambasadës së Kosovës në Jerusalem", thoshin e thonë ende shumë partizanë të majtë në Kosovë, për të cilët djalli banon në Shtëpinë e Bardhë, e jo diku tjetër. Ja cili Bashkim Evropian e kërkon: Shikojeni mirë hartën prapa këtij euroburokratit serbofil që flet dhe vepron në emër të Bashkimit Evropian!", ka shkruar Latifi në profilin e vet në "Facebook".

Edhe Florian Bieber, historian dhe drejtor i Qendrës së Studimeve të Evropës Juglindore në Universitetin e Grazit, ka

reaguar lidhur me hartën që është shfaqur prapa shpinës së emisarit special të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, me Kosovën brenda territorit të Serbisë. "Po, të kesh një hartë të tillë në zyrën tënde me një përshkrim të tillë të punës është një gafë e madhe", ka shkruar Bieber në "Twitter".

Harta që e tregon Kosovën pjesë integrale të Serbisë, madje as pa ndarjen administrative sipas Rezolutës 1244 të OKB-së, dhe që mbahet në zyrën e Miroslav Lajçak, është vërejtur kur i dërguari special i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi dha intervistë nga Brukseli për Platformën EWB (European

Western Balkans).

Nga aty Lajçak ka folur për vizitën që pritet ta bëjë në Prishtinë e Beograd. Ai ka treguar se gjatë vizitës në Kosovë do ta takojë liderin e LV-së, Albin Kurti, i cili pritet të jetë kryeministri i ri i Kosovës. "Albin Kurti është një politikan serioz me mandat të fuqishëm për kohën që po vjen. Sa ishte kryeministër ai hoqi tarifën dhe e bëri të mundur vazhdimin e dialogut. Ai ishte pjesë e bashkëpunimit të suksesshëm me Serbinë për çështje të shëndetësisë. Unë kam qenë në kontakt të vazhdueshëm me Albin Kurtin në krejt këtë periudhë. Natyrisht ai e di se cilat janë pritjet e Bashkimit Evropian", ka deklaruar Lajçak.


KIPRED-i me raport: Mediat serbe dhe ruse prodhuan mijëra lajme të rreme për Kosovën

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Instituti Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) ka publikuar një raport nga monitorimi i mediave serbe dhe ruse, ku thuhet se prodhuan mijëra lajme të rreme dhe dezinformata për Kosovën.

Monitorimi i mediave serbe dhe ruse është një raport tremujor që synon t'i analizojë trendët dezinformues të lajmeve të botuara në publikimet e përzgjedhura mediale në gjuhën angleze dhe serbe që origjinën e kanë në Serbi dhe Rusi, dhe që e vënë në shënjestër Kosovën. Mediat e përzgjedhura që

origjinën e kanë në Serbi dhe që janë të njohura për botimin e lajmeve me përmbajtje dezinformuese janë Tanjug, Informeri, Novosti, Kuriri, B92-shi, Politika dhe Nasa Borba, ndërsa mediat e përzgjedhura përkatëse që origjinën e kanë në Rusi janë Russia Today, Sputnik International, Sputnik Serbia, Meduza, Russia Insider-i, TASS-i, The Moscow Times, Newsfront, Unz, Duran dhe Pravda Report.

Ky Observer i Dezinformatave për Kosovën, po ashtu, i analizon edhe dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën, të botuara nga Kremli dhe nga



Ministria Ruse e Punëve të Jashtme.

Monitorimi i të dhënave

tregon se që nga 1 korrik deri më 30 shtator 2020, publikimet mediale që origjinën e kanë në

Serbi i kanë botuar 1 348 lajme që drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë ndërlidhen me Kosovën.

Trendët dezinformuese të mediave serbe tregojnë se vlera më e lartë në përqindje e raportit lajme/lajme dezinformuese ka qenë në gusht 2020 me 6.7 për qind, vijuar nga 2.3 për qind në korrik dhe nga 1.5 për qind në shtator 2020.

Monitorimi i të dhënave tregon se nga data 1 korrik deri më 30 shtator 2020, publikimet mediale në Rusi kanë botuar 624 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë pasur të bëjnë me Kosovën.

IOM vazhdon përkrahjen e komuniteteve joshumicë



PODUJEVË, 25 SHKURT (ER) - Në kuadër të implementimit të projektit për Stabilizimin e Komuniteteve IV (EU-CSP IV), i cili financohet nga BE-ja dhe menaxhohet nga Zyra e BE-së në Kosovë, Ahmet Ahmeti nga komuniteti ashkali ka përfunduar punë për përpunimin e mishit. Përfaqësuesja e IOM-it dhe


udhëheqësi i zyrës për Komunitete në Komunën e Podujevës, Liman Zeqiri, në kuadër të programit EU-CSP IV, ia kanë dorëzuar përfutuesit Ahmet Ahmeti - pjesëtar i komunitetit ashkali, mjetet e punës për përpunim të mishit, që do ta ndihmojnë për zhvillim të biznesit së tij. Projekti EU-CSP IV, që

implementohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), përkrah komunitetin për integrim të plotë në shoqëri dhe përbush objektivat strategjike që do të kontribuojnë në arritjen e një sistemi gjithëpërfshirës për respekt, barazi dhe integrim për diversitetin e këtyre komuniteteve.

Vdes ish-ushtari UÇK-së, Afrim Alijaj

Gjakovë, 25 shkurt (ER) - Organizata e Veteranëve e Luftës e UÇK-së - Dega në Deçan, ka njoftuar se ka ndërruar jetë ish-ushtari i UÇK-së, Afrim Alijaj nga Dujaka. "Na tronditi shumë lajmi i vdekjes së bashkëluftëtarit tonë Afrim Alijaj nga Dujaka. Ai ishte i dëshmuar në luftën e UÇK-së si ushtar i Brigadës 131 dhe pjesëtar i Batalionit Gardist 'Shkëlzen Haradinaj'. Po ashtu, ishte edhe vëlla i dëshmorit të

kombit Beslim Alijaj. Afrimi ishte një njeri i dashur, i afërt e i mirë, një luftëtar i shquar i radhëve të UÇK-së. Vdekja e tij la të pikëlluar familjen, miqtë, bashkëluftëtarët dhe të gjithë liridashësit", është thënë në njoftimin e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së - Dega në Deçan. Varrimi i ish-ushtarit të UÇK-së, Afrim Alijaj, bëhet sot (e premte) në orën 14:00 në vendlindjen e tij në fshatin Dujakë.



Nis në Prishtinë ndërtimi i Qendrës për Autizëm dhe Sindromën Down

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Në Komunën e Prishtinës ka nisur ndërtimi i Qendrës për Autizëm dhe Sindromën Down. Lajmin e ka bërë me dije kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti. "Qendra për Autizëm dhe Sindromën Down po

ndërtohet me shpejtësi të madhe. Qendra e bashkëfinancuar nga komuna jonë, TIKA si dhe shoqatat Autizmi dhe Syndrome Down do të jetë qendra e parë dhe e vetme e këtij lloji në Kosovë", ka thënë Ahmeti.



Sulmohet fizikisht gazetari Visar Duriqi

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) përmes një reagimi për media thotë me shqetësim të thellë ka pranuar lajmin për sulmin fizik ndaj gazetarit të gazetës online "Insjaderi", Visar Duriqi.

Duriqi mbrëmë rreth mesnatës para banesës është sulmuar fizikisht nga tre persona të panjohur. Gazetari Duriqi për media ka deklaruar se ka marrë trajtim mjekësor në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), pasi si pasojë e sulmit fizik i ka dhëmbët dhe hundën e thyer.

Në lidhje me rastin, për medie është deklaruar edhe Policia e Kosovës. "Menjëherë pas marrjes së informatës policia ka dalë në vendin e ngjarjes dhe në bazë të informacioneve të para, dyshohet se tre persona të maskuar kanë sulmuar me grushte viktimën në hyrje të banesës së tij duke i shkakuar lëndime trupore. Viktima është dërguar në QKUK, për trajtimin e nevojshëm mjekësor dhe më pas është liruar nga aty", thuhet në deklaratën e policisë.

Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) ka theksuar se sulmi fizik në drejtim të gazetarit Visar Duriqi është shqetësues dhe i rrezikshëm për lirinë e

shprehjes. "Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës kërkon nga organet e drejtësisë që sa më shpejt t'i hetojnë motivet e sulmit dhe ta zbardhin këtë rast, i cili në themel dëmton lirinë e shprehjes dhe medias. AGK-ja do t'i njoftojë të gjithë aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë lidhur me këtë rast dhe njëherësh iu bëjmë thirrje të gjithë kolegëve tanë gazetarë që t'i raportojnë kërcënimet dhe sulmet në drejtim të tyre. Çdo sulm në drejtim të gazetarëve është sulm ndaj fjalës së lirë dhe demokracisë në vend", është thënë në reagimin e AGK-së.

Sulmin ndaj Duriqit e kanë dënuar edhe përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, përfaqësues të partive politike dhe përfaqësues të shoqërisë civile.



Visar Duriqi: Nuk kam dyshime për sulmin

Visar Duriqi ka thënë për REL se nuk dyshon në askënd për kryerje të sulmit pasi, sipas tij, me emisionin "In Doks" ka prekur çështje të ndryshme "të interesit si ato me korrupsion, krim të organizuar, grupe fetare e të tjera". Ai ka thënë se personat që e kanë sulmuar kanë

qenë të maskuar dhe me kapela. "Më kanë tërhequr në një skaj ku nuk ka kamera, vend ku është e vështirë të shihet diçka nga kamerat. Kjo nënkupton se ata e kanë njohur vendin ku duan ta kryejnë sulmin. Shumë mirë e kanë ditur saktë ku nuk ka kamera", ka

deklaruar Duriqi.

Ai ka folur edhe për pasojat e sulmit. "Sipas incizimeve që i kam bërë, i kam, së paku, katër dhëmbë të thyer, hundën dhe kam lëndime të tjera, lëndime kryesisht në shpinë dhe te pjesa e epërme e trupit", ka thënë ai.

Për rastin për keqpërdorimin e subvencioneve kërkohet paraburgim për 11 persona

Prokuroria Themelore ka kërkuar të enjten paraburgimin e 11 personave, pas dyshimeve për marrje dhe dhënie të ryshfetit, keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe dhënie të ndihmës për kryerjen e veprave penale. Masa e paraburgimit është kërkuar për personat e ndaluar pas një aksioni të Policisë së Kosovës më 24 shkurt në komunat Prishtinë, Podujevë, Gjilan, Istog dhe Lipjan

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda - Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion, ka njoftuar se nga bastisja e realizuar më 24 shkurt 2021 në komunën e Prishtinës, Podujevës, Gjilanit, Istogut e Lipjanit, me aktvendim të Prokurorit të Shtetit, janë ndaluar personat me inicialet S. Sh., L. S., S. S., H. M., B. N., K. Z., A. U., D. A., P. K., Sh. K., K. B-S., ndërsa personi me inicialet A. N. vetëm është shoqëruar në stacionin policor dhe i njëjti është liruar në procedurë të rregullt. "Nga kjo bastisje e

realizuar janë konfiskuar: rreth 433 160.00 (katërqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) euro, 600 (gjashtëqind) dollarë, 200 (dyqind) franga, 275 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lira turke, 15 (pesëmbëdhjetë) telefona, 8 (tetë) vetura, 1 (një) kompjuter, 5 (pesë) armë, 1 (një) USB dhe 1 (një) vulë", ka njoftuar Prokuroria Themelore Prishtinë.

Sipas këtij njoftimi, Prokurori i Shtetit ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën Themelore në Prishtinë për personat me inicialet S. Sh., L. S., H. M., B. N., K. Z. dhe A. U., për shkak të dyshimit se të njëjtët kanë kryer veprat penale "Marrja e ryshfetit", nga neni



421 i KPRK-së dhe "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", nga neni 414 i KPRK-së, për personat me inicialet D. A., P. K., Sh. K., K. B-S., për shkak të dyshimit se të njëjtët kanë kryer veprat penale "Dhënie e ryshfetit", nga neni 422 i KPRK-së dhe "Keqpërdorimi i pozitës apo

autoritetit zyrtar", nga neni 414 i KPRK-së, si dhe për personin me inicialet S. S., për shkak të dyshimit se i njëjti ka kryer veprën penale "Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale", nga neni 380 i Kodit Penal i Republikës së Kosovës. Kryeministri në detyrë i

Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se pret hetim të plotë pas aksionit policor. "Fajtorët duhet ta marrin dënimin maksimal. Këta njerëz nuk e meritojnë të jenë në institucione", ka thënë Hoti të mërkurën në një shkrim publikuar në rrjetin social "Facebook".

FKGK-ja sqaron procedurat për përfitimin e bizneseve nga rimëkëmbja ekonomike



Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë së bashku me përfaqësuesit e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) kanë organizuar tryezën lidhur me situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 dhe ndikimin e saj në aktivitetin ekonomik

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Shpërthimi i pandemisë Covid-19 ka ndikuar në aktivitetin ekonomik, duke kufizuar funksionimin e shumë industrive dhe duke ndikuar në rënie të mëdha të qarkullimit.

Roli i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), për lehtësim të qasjes në financa, procedurat që duhet t'i ndjekin bizneset për të shfrytëzuar garantim nga ky fond, limitet e financimit nga i njëjti si dhe roli i bankave komerciale për përcaktimin e përfituesve, u diskutuan në tryezën e

organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, me panelistë përfaqësues nga ky fond, si dhe sektori bankar në vend.

Drejtori ekzekutiv i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Besnik Berisha, ka folur mbi rolin e këtij institucioni në ndihmën për qasje në financa ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me fokus në aktivitetin e të njëjtit në pjesën e rimëkëmbjes ekonomike.

Sipas Berishës, FKGK-ja nëpërmjet garantimit të portofolit kreditor të bankave partnere ka arritur të ndihmojë në lehtësimin e qasjes në financa për bizneset vendore, konform me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike.

Ai ka theksuar se në këtë periudhë Fondi ka rritur mbulueshmërinë me garanci

kreditore deri në 80 për qind të vlerës së kredisë, krahasuar me vlerën e mëparshme të mbulueshmërisë prej 50-përqindësh.

Berisha ka njoftuar se për shfrytëzim të këtij fondi bizneset duhet të aplikojnë për kredi në banka komerciale dhe t'i kalojnë procedurat e bankës, ndërsa nëse vlera e kolateralit të tyre është e pamjaftueshme, bankat kanë në diskrecion mundësinë e lëshimit të kredisë, duke shfrytëzuar garancinë nga FKGK.

Moderatori i këtij forumi, Blin Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në Art House, ka theksuar nevojën për qartësim të procedurave të kredimarrjes së garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore meqë, sipas tij, bizneset në këtë kohë kanë nevojë për mbajtje të

likuiditetit ose për investime të reja dhe janë të interesuara t'i shfrytëzojnë mundësitë e ofruara nga ky institucion.

Po ashtu, Zeqiri ka theksuar nevojën e diversifikimit të produkteve financiare, me fokus në mbështetjen për bizneset fillestare dhe uljen e kriterëve të financimit për bizneset që nuk kanë kolateral të mjaftueshëm.

Në diskutim morën pjesë edhe drejtues të bankave komerciale në vend, të cilët sqaruan procedurat për kreditim të bizneseve në periudhën aktuale të rimëkëmbjes, përfshirë këtu edhe vënien në përdorim të mekanizmit garantues të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, si dhe lehtësirat që ata kanë aplikuar për bizneset pas shpërthimit të pandemisë Covid-19.

Ministria e Infrastrukturës financon disa projekte infrastrukturore në Gjakovë

Prishtinë, 25 shkurt (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, të enjten ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me kryetarin e Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini. Me firmosjen e këtij dokumenti mundësohet ndërtimi dhe asfaltimi i disa rrugëve në këtë qytet, për të

cilat ministri Abrashi theksoi rëndësinë e tyre për mirëqenien e banorëve të Gjakovës.

Ndërtimi i rrugës hyrëse në Gjakovë nga ana veriore, nga drejtimi i Pejës dhe i rrugës transite që lidh rrugën hyrëse nga Peja me rrugën hyrëse nga Prishtina, bashkë me

asfaltimin e shtatë rrugëve të tjera, janë pjesë e kësaj marrëveshjeje, përmes së cilës MI është financuese e projekteve. Këto projekte janë pjesë e marrëveshjeve të reja me komunat e Republikës së Kosovës dhe parashohin financimin e ndarë në disa faza.



KOSTT-i nënshkruan marrëveshje me Solar Energy Europe



PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i KOSTT-it, Mustafë Hasani dhe drejtori i kompanisë Solar Energy Group Europe, Egbert Schnuse, kanë

nënshkruar marrëveshjen për kyçje në sistemin e transmetimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë me diell, me kapacitet

gjenerues prej 150 MWp. "Stacioni gjenerues energjetik me diell do të kyçet në rrjetin transmetues 110kV përmes linjës së re 110 kV me gjatësi rreth 6.5 km, e cila do të

lidhet në NS 110/35kV Gjakova 1', ka njoftuar KOSTT.

Pas shqyrtimit të aplikacionit nga KOSTT dhe nënshkrimit të marrëveshjes për kyçje në

sistemin transmetues, Solar Energy Europe planifikon ta ndërtojë projektin në Komunën e Gjakovës dhe ta fillojë prodhimin e megavatëve të parë në vitin 2022.

Ambasadori Minxhozi: Kosova shpëtoi turizmin e Shqipërisë



PRISHTINË, 25 SHKURT - Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, në një intervistë për "Telegrafi.com", ka thënë se qytetarët nga Kosova e kanë shpëtuar turizmin e Shqipërisë gjatë vitit të kaluar.

Minxhozi ka thënë se gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 është shquar një solidaritet ndërmjet autoriteteve shqiptare me ato të Kosovës. "Është shquar një solidaritet ndërinstucional i autoriteteve të Shqipërisë në të gjitha fushat me autoritetet e Kosovës. Natyrisht ka pasur një rënie të ekonomisë në masën 10 për qind të shkëmbimeve

krahasuar një vit më parë, që është diçka krejt normale, më e vogël se në atë çfarë mendonim më parë të ndodhte. Në qoftë se Shqipëria dhe Kosova gjatë vitit 2019 kanë shkëmbyer 307 milionë euro, në vitin 2020 kjo shifër ra në 275 milionë euro. Me gjithë masat që kanë qenë si në Shqipëri dhe Kosovë, bizneset kanë mundur t'i shkëmbejnë produktet që i kanë shkëmbyer më parë, kur nuk kanë pasur pandemi", u shpreh Minxhozi. Sipas tij, përveç rënies së shkëmbimeve tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, sektori që ka pësuar rënie më të madhe ishte ai i turizmit.

Mustafa me ambasadorin gjerman diskutojnë për bashkëpunimin mes dy vendeve

Prishtinë, 25 shkurt (ER) - Ministri në detyrë i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Jorn

Rohde. Në këtë takim u diskutua kryesisht mbi zhvillimet e fundit në vend. Ministri Mustafa ka falënderuar ambasadorin Rohde për mbështetjen e deritanishme si dhe për

gatishmërinë për mbështetje të mëtejme të shtetit gjerman ndaj Republikës së Kosovës, duke potencuar se bashkëpunimi mes dy vendeve do të vazhdojë të thellohet.



KADARE DHE KOSOVA (4)

PA E DITUR ASKUSH, KADARE BËHET AMBASADORI I PARË I MADH I ÇËSHTJES SË KOSOVËS

Bedri ISLAMI

Kur Teuta Hadri u arrestua për herë të parë dhe milicët serbë vajtën në shtëpinë e saj, mes të tjerave, atë e akuzuan edhe se në shtëpinë e saj kishin gjetur librat e Kadaresë botuar në Tiranë. Është në akuzën e saj zyrtare dhe e pyesin gjatë për të. Një inkuzicion i pamatshëm për librat e një shkrimtari, i cili edhe pse një vit më parë është botuar zyrtarisht në Prishtinë dhe vetë autori ka pasur takime në institucionet e Krahinës, përsëri vazhdon të mbetet i rrezikshëm.

Dëshmitë në librin e Teuta Hadrit do të jenë tronditëse. Shpeshherë, kur lexoja librin e saj, më vërvitej në kujtesë personazhi kadarean Shpend Brezftohti, studenti që synoi të shkrinte krushqit e ngrirë, pastaj toka e lagësht, më saktë nëntoka dhe dherat mbi shtatin e tij, ku hëna, sado e bardhë të ishte, nuk arrinte dot; pastaj ajo rrëkeze e nëndheshme, që ia shrinte një pjesë të flokëve përpara, në drejtim të rrjedhës së vet, sikur dora e nënës ia përkëdhelte dhe ia krihte vazhdimisht, ndërsa rrëzë maleve të Sharrit, aty ku dëborat e paktë e fundprillit mbi shkëmbinjtë dukej vërtet si krushqit e ngrirë. Teuta Hadri do t'i përjetonte nga afër skenat e kriminit që nga mbyllja e syve të grave, fëmijëve dhe burrave të familjes Jashari, deri te të afërmit e saj.

Do të ishte një nga gratë intelektuale, poete njëkohësisht, mjekje e shquar, që do të dënohej edhe për adhurimin e saj ndaj një poeti të shquar të kombit.

Kadare në Kosovë nuk është trajtuar kurrë veçse si një shkrimtar i madh. Mbi të gjitha ai është parë, ashtu si ishte, një atdhetar i madh.

Pak vite më vonë Kadare do të shkruajë përsëri për një ngjarje reale, vrasjen e poetit militant Jusuf Gërvalla, i cili në mesnatën e 17 janarit 1982 do të vritej nga shërbimi sekret serb, së bashku me mikun e tij, gazetarin Kadri Zeka dhe të vëllanë, Bardhoshin.

Romani, me titullin më të mirë të mundshëm që do t'i përshtatej Jusuf Gërvallës "Baladë për J. G." Është, në fakt, vazhdim i denoncimit të kriminit që ka ndodhur në Kosovë.

Jusuf Gërvalla ishte poet, gazetar, muzikant, një ndër njerëzit më shpirtthapur dhe botëformues, prania jetësore e të cilit po bëhej përherë e më e rrezikshme. Për të gjitha shtetet totalitare një shkrimtar i madh është edhe një i rrezikshëm i madh.

Stendal ka shkruar se "meriton të hidhet në letër vetëm ajo që është interesante dhe pasi historia e ka thënë fjalën e saj".

Mirëpo, ndodh edhe ndryshe. Jo gjithnjë dhe jo nga të gjithë. Ndodh që shkrimtarët e mëdhenj gjejnë forcën për të skalitur atë pjesë historie që mund të jetë e denjë si e tillë. Bëhen pararendës të saj. Përçues. Lajmës. Skalitës, më në fund.

Mjeshtrit e vërtetë nuk kanë nevojë që historia të ngurtësohet përfundimisht, pra kur ajo të jetë e ftohtë, e pandryshueshme dhe solide. Ata, me subkoshiençën e tyre, nganjëherë verbuese, risjellin atë që është më qëndrues në jetën e një kombi: njerëzoren, të vyeshten, si është në këtë roman portreti i Jusuf Gërvallës, ku shpirti ka dalë mbi uniformat, flamujt e egërsisë, ngërçet e vdekjes, shtrëngimin e dhëmbëve, çmendurinë e përgjithshme. Ai është njerëzor deri në çastin e fundit, i vetëdijshëm se çfarë ka ndodhur me të dhe, në një mënyrë a në një tjetër, mund të quhej edhe ai Shpend Brezftohti, ripërsëritje, i rivrarë, përsëri në një kohë të ngrirë, jo vetëm se është mesi i janarit; për më tepër në një dhe të huaj, ku do të rrijë shumë e shumë vite, deri në rikthimin e tij në Kosovë.

Për të shkruar një roman të tillë nuk është e mjaftueshme të jesh shkrimtar i madh, si është Kadare ndër më të mëdhenjtë. Të gjitha do të ishin të mangëta, të shprishura, do të ishte gjithçka si në ato çastet e qeta të historisë, kur ajo është ngurtësuar; e bukur, por pa atë ndjenjën e mirëbesimit, pjesë e një statue me sy të ftohtë, nëse nuk ke në vete atë ndjenjën e veçantë të mirëkuptimit të aktit sublim të një njeriu-poet e luftëtar, që, edhe pse e di se erdhi çasti i ikjes, nuk do të lërë sherr pas vetes, nuk do të jetë pjesë e diferencimit, ndarjes, mërisë, egërsisë dhe, belbëzon si fjalët e fundit të një jete të urtësishme, se, në qoftë se dorasit janë shqiptarë, kurrë mos u zbulofshin. E vrasësi dihet, i dyfishtë, i kundërti i Teuta Shkrelit, mjekes kirurge që mjekon plagët e kujtdo. Një mjek praktikant serb, në fakt më shumë ushtar se njeri human, do të jetë pjesë e vrasjes së poetit. Pjesa e dytë e vrasjes së tij. Më parë se në letër, Jusuf Gërvalla është në zemër, është simbioza e poetit, vëllai i tij, e ndoshta edhe fati i tij.

Duhet të jesh edhe guximtar për të thënë një të vërtetë nga e cila, mund të kthehesh në orakull i vetvetes.

Shpesh herë kam menduar se sa vite përmbahen në një të vetëm: vitin 1981.

Jo të gjithë e kuptuan menjëherë atë. Disa, edhe sot, ende nuk e kanë kuptuar se sa i madhërishtë ishte ai.

Kadare ishte ndër të parët që, jo vetëm e kuptoi, por edhe e rroku



atë. Në fakt, të gjitha momentet madhore të historisë së Kosovës, pra vitet e shndërrimeve të saj, ai, jo vetëm i kuptoi, por me qetësinë shpirtërore të pazakontë, u bë pjesë e tyre, e shpesh herë pararendës. Nga secili krijim i tij që lidhet me këto periudha të veçanta, sidomos në trekëndëshin 1981 - 1989 - 1998, pra pranverën e madhe të vitit 1981, lëvizjet e mëdha për republikën dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, zbulohet një galeri personazhesh, përmes të cilëve mund të kuptohet realisht ajo që ka ndodhur në Kosovë, e jo vetëm aq, e fuqishme në hapësirën e krijuar, e pamatshme nga vizioni, afërsi njerëzore dhe njëkohësisht ndjesi përkushtimi - vetëm përmes tyre mund të konceptohet hapësira e Kadaresë e krijuar nga vetë ai dhe e përfaqësuar nga njerëzit.

Asnjë shkrimtar tjetër nuk ka qenë më i lidhur me Kosovën, se sa vetë ai; askush nuk është kuptuar më qartësisht dhe nuk është dashur, nganjëherë çmendurisht. Kjo vepër bëhet gjithnjë e më e pamatshme, sa herë që synojmë të depërtojmë në të, si në ato galeritë që të shpien drejt thelbit, dhe që, në këtë rast, është e pambarueshme.

Në Kosovë ai ishte gjithnjë i paprituri që pritej me ankth, në të gjitha kohërat. Ai ishte ngjarje. Ai mbetet ngjarje. Kjo nuk ka të bëjë me dëshirën njerëzore. Është ngurtësuar tani.

Ka pasur gjithnjë një moskuptim të madh mes çështjes së shqiptarëve në Kosovë dhe Perëndimit. Ka pasur pikëpyetje, hatërmbetje, mallkime, belbëzime, furtuna të ngritura e të përfunduara pa rënë asnjë pikë shi i bereqetshëm, përçarje, rendja drejt vendeve të

lindjes, komunizëm; përsëri mallkime dhe vetmi, një vetmi e gjatë, e mbrapshtë dhe mizore. Perëndimi më shumë është shfaqur si fantazmë, Lindja komuniste si galaktikë diellzuese. Në fakt kishte qenë e kundërta. Zemërimi me Perëndimin kishte qenë më shumë me pamundësinë për të ju afruar, e më tej, për ta kuptuar. Thënia e Naim Frashrit se "dielli lind andej nga perëndon", nuk kishte qenë veçse poetike, por joshje, thirrje, brengë, mesazh dhe shpresë. Në shumë vite vetmi, kur kishte ardhur mundësia e hapjes, të ngutshëm si shpesh herë dhe inatçorë të krisur, te shqiptarët kishte pasur ndjellje të fatalizmit dhe pesimizmit.

Kadare, njohës i shkëlqyer i shpirtit të një populli që ishte ende i hutuar dhe rruga i kishte humbur disa herë në oborrin e shtëpisë së tij, do të përhapte idenë e saktë se, të jepesh pas fatalizmit është si të ngresh duart e të dorëzohesh. Fati i shqiptarëve në Kosovë nuk është aq i zymtë sa duan ta bëjnë disa. Ai bën thirrje njerëzve as të mos zemërohen, as të mos mallkojnë, madje të shajnë dhe të leçitin, si propozuan "kokat e nxehta", apo një rrymë "moderne", e cila, duke mohuar gjithçka mendonte se mund të afrohej dhe të bëhej më e besueshme.

Si mund të ngrihemi e të zemërohemi me Perëndimin, bën thirrje ai, si mundemi madje ta shajmë dhe ta mallkojmë? Evropa dhe ShBA janë synimi ynë, horizonti, shpresa jonë. "Ndryshe, drejt ç'yllnaje tjetër do të orientohemi"?

Kombi kishte dashur gjithnjë një përfaqësues të tij, ndoshta të pashpallur zyrtarisht, por të njohur si të tillë vetvetiu, i cili të

kishte në vete aftësinë për të bartur një mision të tillë, të ishte i besuar, aureola rreth tij të ishte e natyrshme dhe fjala të kishte peshën e duhur.

Kadare bëhet, pa e ditur askush, ambasadori i parë i madh i çështjes së Kosovës. Ai është i njohur, shkrimtar i madh; natyra e tij e qetë, por edhe zemërimi tipik gjirokastrit e bëjnë më të vyerin në këtë fushëbetë që sapo ka nisur.

Letër këmbimi i tij me personalitet më të mëdha botërore është thelbësisht për Kosovën, sidomos pas vitit 1991.

Në bindjen e tij është prioriteti i kombit çështja e Kosovës. Mirë a keq, Shqipëria londineze ka hyrë në një rrugëtim, duan apo nuk duan liderët, gjërat mund të zgjaten, por do të bëhen, ndërsa në Kosovë ky është momenti i fundit.

Ai i drejtohet Georg Bushit, presidentit francez Miteran, presidentit çek, shkrimtarit të njohur Havel, Papës së shenjtë Gjon Pali i Dytë, Presidentit Shirak, Ministrisë së Jashtme franceze, delegacionit shqiptar në Rambuje, takon statura të shquara të botës diplomatike, shfrytëzon të gjitha tribunat ku është i ftuar a i nderuar, pa reshtje, të flasë për Kosovën, të shkruajë; një cikël librash të shquar bëhen pjesë e jetës së përditshme njerëzore dhe fitojnë qytetarinë më shpejt nga sa janë përhapur dhe, ata, librat, janë plot dritë, ngazëllim, shpresë, brengë, përplasje, zemërim, vuajtje, shend, mallkim për kokëkrisjen shqiptare, dhe gjithçka, ose thujase gjithçka që vërvitet rreth fatit të Kosovës, atij i intereson furishëm. (Vijon)

Besëtytnitë shqiptare, për miqtë dhe miqësitë

Në librin “Zakone e doke shqiptare”, mbledhur nga At Donat Kurti dhe botuar pas vdekjes së tij nga françeskanët shqiptarë, në fund të çdo kapitulli vendosen besëtytnitë që lidhen me çdo krahinë e zakon. Kështu, në fund të kapitullit “Miqsija në Dukagjin”, në pikën e katërt shkruhet:

“Besëtytni në lidhni me mik.

– Kur gatojca (gruaja që po gat-

uan), tuj ngjeshë brumin e bukës, len pa dashtë në gisht një quk (pak) brumë, thohet se vjen një mik (Dukagjin).

– Kur, tuj u ndezë krundet (drunj të hollë e të thatë që përdoren për të ndezur zjarrin) në zjarm, çohet një krande piripuç përpjetë e jep flakë të shpejtë, thohet se vjen një mik (Dukagjin e Malsi e Madhe).

– Kur grueja bjen në sofër një

lugë ma tepër, thohet se vjen një mik (Malsi e Madhe).

– Kur, tuj u çue enët prej sofret, bjen gabimisht një lugë për tokë, thohet se miku asht çue pa u ngi (Malsi e Madhe).

– Kur, tuj hanger në sofër, harron ndonjeni një kafshatë bukë në njenen anë, thohet se do të vijë një mik në atë mbramje, në kjoftë mjesditë, do të vijë nesër (Shkodër).

– Kur grizhla gërzhatë (bërtet) n’oborr të shpisë, sidomos nade, thohet se me siguri do të vijë ose një mik, ose një lajm (Shkodër e Malsi e Madhe).

– Kur në darkë, ndërsa gjindja e shpisë janë tuj hangër bukë, këndon gjeli një herë, thohet se mrenda pak ditëve des një mik; në kjoftë se këndon dy herë, thohet se desin dy (Mirditë e Dibër).

– Po u rrxue pula prej vendit ku asht tuj pushue, thohet se humbet një mik (Malsi e Madhe).

– Me këndue pula thohet se ka me pas dëm shpija, asht mirë me e mbyt pulen për mik (Malsi e Madhe).

– Me hung rue qeni thohet se des një rob ose një mik (Shkodër”).



SHKOLLA E BOTËS ME KOKË POSHTË

Nga: **Eduardo GALEANO**

Ecja është një rrezik dhe frymëmarrja është një heroizëm në qytetet e mëdha të botës me kokë poshtë. Kush nuk është rob i nevojës, është rob i frikës: disa nuk i zë gjumi nga ankthi për të pasur atë që s’kanë; të tjerët nuk i zë gjumi nga paniku se mos humbasin atë që kanë. Bota e përmbysur na stërvit që ta shohim fqinj tonë si një kërcënim dhe jo si një premtim, na ndrydh në vetmi dhe na ngushëllon me droga kimike dhe me miq kibernetikë. Jemi të dënuar të vdesim nga uria, apo nga frika, ose të vdesim nga mërzia, nëse nuk e shkurton jetën ndonjë plumb qorr.

A është kjo liria, liria për të zgjedhur midis këtyre fatkeqësive që na kërcënojnë, e vetmja liri jona e mundshme?

Bota me kokë poshtë na mëson të vuajmë realitetin në vend që ta ndryshojmë atë, na mëson të harrojmë të kaluarën në vend që ta dëgjojmë atë, na mëson që të pranojmë të ardhmen në vend që ta imaginojmë atë. Kësisoj, kjo botë e përmbysur praktikon krimin dhe e rekomandon atë. Në shkollën e saj, shkolla e krimin, mësimet për dobësi, amnezi dhe nënshtrim janë të detyrueshme. Ama dihet mirë se nuk ka fatkeqësi pa gëzim, as fytyrë që nuk ka anën tjetër, as ligështim që nuk kërkon guxim. Gjithashtu, nuk ka shkollë që nuk e gjen antishkollën e saj.

Telegrafi / Bajram Karabollli



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Drenica merr tri pikë kundër Feronikelit, Arbëria mposht Besën

Drenica ka marrë tri pikë në Drenas, por kjo humbje "Niklin" e ka futur edhe më shumë në mesin e skuadrave që rrezikohen për të rënë nga Superliga. Arbëria shfrytëzoi për mrekulli përballjen ndaj Besës për t'i marrë edhe tri pikë të reja në garën për të mbijetuar në elitë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 SHKURT - KF Drenica e ka mposhtur Feronikelin në ndeshjen e javës së 21-të në Superligë (1-3), e cila është zhvilluar të enjten në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Në minutën e 18-të Kreshnik Uka e kaloi në epërsi skuadrën e Drenicës (0-1), por "Nikli" e barazoi rezultatin nëpërmjet Simonovskit. Në minutat shtesë të pjesës së parë, Besmir Bojku i vendësve u ndëshkua me karton të kuq, kurse një minutë më pas Frashëri e kaloi skuadrën kuqezi për herë të dytë në epërsi (1-2). Në pjesën e dytë, saktësisht nëntë minuta pa përfunduar ndeshja, Uka e vulosi rezultatin final 1-3. Pas kësaj ndeshje, Feronikeli mbetet në pozitën e shtatë me 24 pikë të grumbulluara, kurse Drenica është e parafundit me 23 pikë. Pas ndeshjes trajneri i Feronikelit,



Klodian Duro, ka thënë se kartoni i kuq i ka dhënë një rrjedhje tjetër ndeshjes. "Kartoni i kuq që morëm dhe goli më pas i dhanë një tjetër rrjedhë ndeshjes. Mendoj se goli i dytë i Drenicës ishte në pozicion jashtë loje. Nuk dua të merrem me gjyqtarët, por vendimet e tyre janë statistika që ndikojnë në ndeshje", ka deklaruar Duro.

Në ndeshjen tjetër Arbëria e mposhti Besën me rezultat 0-3, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Tahir Vokshi" në Brestovik të Pejës. Shtatë minuta i kanë mjaftuar skuadrës që drejtohet nga Arbënor Morina për të kaluar në epërsi 0-1. Shënues ishte Marclei. Skuadra

mysafire e vazhdoi dominimin edhe në minutat në vazhdim dhe Kreshnik Bahtiri realizoi në minutën e 33-të për rezultatin 0-2. Në fillim të pjesës së dytë Almir Kryeziu e vulosi rezultatin final 0-3. Arbëria pas tri pikëve të reja është në pozitën e gjashtë me 25 pikë, kurse Besa e fundit me vetëm 7 pikë. Të mërkurën janë zhvilluar tri ndeshjet e tjera, ku Prishtina e mposhti në derbi Dritën me rezultat 2-0, duke e hapur edhe me shumë garën për titull të kampiones në elitë. Ndërsa Gjilani mbeti baras me Ballkanin (1-1), ndërsa Trepça '89 e ka vazhduar formën e mirë në Superligë, pasi e ka mposhtur edhe Llapin me rezultat 1-0.

SUPERLIGA - Java 21

Feronikeli - Drenica	1-3
Besa - Arbëria	0-3
Gjilani - Ballkani	1-1
Trepça '89 - Llapi	1-0
Prishtina - Drita	2-0

Tabela

1. Ballkani	21	45 pikë
2. Drita	21	44
3. Prishtina	21	41
4. Gjilani	21	31
5. Trepça '89	21	28
6. Arbëria	21	25
7. Feronikeli	21	24
8. Llapi	21	23
9. Drenica	21	23
10. Besa	21	7

Në xhiron e radhës takohen: Drita-Besa, Trepça '89-Prishtina, Drenica-Gjilani, Llapi-Ballkani, Arbëria-Feronikeli.

SHKURT

Vojvoda: Nuk kam pasur asnjëherë lidhje me ndonjë vajzë, gruan e dua shqiptare

Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës dhe skuadrës së Torinos, Mërgim Vojvoda, ka folur edhe për jetën e tij private. Ai ka thënë se nuk ka pasur asnjëherë lidhje dashurie me ndonjë vajzë dhe momentalisht është "single". "Nuk kam pasur asnjëherë lidhje me ndonjë vajzë. Nuk ka rëndësi çfarë stili ka, vetëm se normalisht duhet të jetë shqiptare. Pasi unë jam besimtar, mundësisht të jetë edhe myslimane", ka thënë Mërgim Vojvoda në "Duelin Sportiv" në RTV.

Në fundjavë grumbullohet U14-shat

Të shtunën dhe të dielën do të bëhet grumbullimi i parë në konkurrencën e meshkujve U14 në kuadër të projektit zhvillimor YDF. Ky grumbullim është i mirëseardhur për t'i parë nga afër talentët e rinj dhe për masivizimin e basketbollit në Kosovë. Federata e Basketbollit e Kosovës tash e pesë vjet është pjesë e projektit të FIBA-s për Zhvillim të Gjeneratave të Reja, por në vitin 2019 projekti ka filluar të implementohet edhe për vajza, gjë që shërben në dobi të zhvillimit të basketbollit në konkurrencën e femrave. Grumbullimi do të bëhet të shtunën dhe të dielën nga ora 12:00-14:00, në shkollën "Don Bosco".

Formacioni i javës në Ligën e Kampionëve

Gjatë kësaj jave janë zhvilluar edhe katër ndeshje në kuadër të Ligës së Kampionëve për fazën e 16 të finales. Të martën Chelsea e mposhti me rezultat 1-0 Atletico Madridin, ndërsa Bayerni triumfoi me rezultat të thellë 4-1 ndaj Lazios. Real Madridi fitoi me rezultat minimal 1-0 ndaj Atalantës, e Manchester City vazhdoi formën fantastike duke fituar 2-0. Ndërsa "WhoScored" ka publikuar formacionin më të mirë të kësaj jave: M. Neuer (Bayern), K. Walker (Manchester City), C. Azpilicueta (Chelsea), Nacho (Real Madrid), J. Cancelo (Manchester City), L. Sane (Bayern), B. Silva (Manchester City), T. Kroos (Real Madrid), M. Alonso (Chelsea), J. Corraera (Lazio), R. Lewandowski (Bayern).

'Tigrat e Zi' kërkojnë largimin e Klodian Duros

DRENAS, 25 SHKURT - Skuadra e Feronikelit nuk e ka nisur mirë sezonin pranveror, pasi në katër ndeshjet e fundit ka regjistruar tri humbje dhe një barazim. Trajneri Klodian Duro është në qendër të kritikave të ashpra të tifogrupit "Tigrat e Zi" që mbështet skuadrën nga Drenasi. "Tigrat e Zi" kanë kërkuar

dorëheqjen e trajnerit nga Shqipëria, duke e quajtur analist dhe jo trajner. "Kërkesë për Klodian Duro. Nga ti analist i Superligës sonë, ne qysh tani kërkojmë dorëheqje sepse ne nuk të lejojmë atë që ke bërë deri sot në klubin tonë të zemrës. Kërkojmë edhe nga presidenti ynë, Naser Ramaj, që sonte ta marrë vendimin për ty

analist. Nëse askush nuk merr masa për ty, ti nuk do të jesh i sigurt në klubin tonë sepse ti ke larguar lojtarët nga klubi pa asnjë arsye, ti ke bërë edhe një grup lojtarësh nga ana jote dhe nuk je duke i futur në lojë ata të cilët janë të gatshëm të luajnë nga minuta e parë", thuhet në kërkesën e tifozëve "Tigrat e Zi".



Më 25 mars mbahen zgjedhjet për president të KOK-ut

PRISHTINË, 25 SHKURT - Asambleja e Punës dhe Zgjedhore e Komitetit Olimpik e Kosovës do të mbahet më 25

mars nga ora 15:00. Vendimi për mbajtjen e zgjedhjeve më 25 të muajit të ardhshëm është marrë të enjten në mbledhjen

e Bordit të KOK-ut. Kundërkandidatë të presidentit aktual, Besim Hasani, janë deklaruar se do të jenë edhe

Ismet Krasniqi, Milaim Kelmendi dhe Linda Shala, ndërsa Afërdita Fazlija nuk e ka pohuar as mohuar



Lakersat pësojnë humbjen e katërt radhazi

Salt Lake City, 25 shkurt - Utah Jazz tregon forcën e saj edhe përballë kampionëve në fuqi të NBA-së. Skuadra nga "Salt Lake City" mposhti pa shumë vështirësi Los Angeles Lakersin me rezultatin e thellë 114-89. Një ndeshje e dominuar nga kryesuesit e Konferencës së Perëndimit të cilët e panë veten në avantazhin e plotë 16 pikëve që në fundin e pjesës së parë. Për Lakersat vijon momenti negativ pasi kalifornianët pësuan humbjen e 4-t rresht. Mungesat e Antony Davis i cili ka dëmtuar tendinën e akilit, por edhe të gjermanit Denis Schroder po ndihen shumë te skuadra e Frank Vogel. LeBron James edhe këtë herë nuk arriti të bënte asgjë i vetëm teksa e mbylli sfidën me 19 pikë, 4 rebounde dhe 4 asistime. Tek Utah më të mirët mbi parket

rezultuan Jordan Clarkson, ish-lojtar i Lakersave dhe francezi Rudy Gobert, me nga 18 pikë secili, ndërkohë që një paraqitje të mirë bëri edhe kroati Bogdanoviq, raporton "Supersport". Moment pozitiv edhe për Golden State Warriorsin që mori fitoren e dytë rresht, pasi mposhti brenda në Indianapolis Indiana Pacersin me rezultatin 111-107. Stephen Curry ishte ai që udhëhoqi skuadrën nga "San Francisco" drejt suksesit të 18-të sezonal në 33 ndeshje, me yllin e Warriorsit që spikati me 24 pikë, 8 rebounde dhe 8 asistime. Në krahun tjetër Indianës nuk i mjaftuan 46 pikët e koleksionuara në total nga dyshja Brogdon - Sabonis. Kanë rigjetur formën ideale edhe nënkampioni i edicionit të kaluar i NBA-së, Miami Heat, i cili triumfoi në

"American Airlines Arena" përballë Toronto Raptorsit me shifrat 116-108. Jimmy Butler ishte thjesht fantastik për Miamin teksa koleksionoi në total 27 pikë, 8 rikuperime poshtë tabelës dhe 10 pasime vendimtare. Te Raptorsi, i cili pësoi humbjen e 17 sezonale, spikatën Kyle Lowry dhe VanVleet me nga 24 pikë secili. Për Miami Heat kjo ishte fitorja e 4-t rresht por, pavarësisht kësaj, skuadra nga Florida për momentin pozicionohet në vendin e 10-të në Lindje dhe është jashtë zonës "play-off". Vijon rënia e lirë për Boston Celticsin që u mposht në Georgia nga Atlanta Hawks me rezultatin 127-112. Italiani Danilo Gallinari me 38 pikë dhe talenti Trae Young me 33 pikë ishin dy basketbollistët që udhëhoqën Atlantën drejt kësaj fitoreje të rëndësishme.



UEFA, 12 topa donacion për klubin e Mabetex Prishtina

Prishtinë, 25 shkurt - Klubi i futsallit Mabetex Prishtina është shpërblyer nga shtëpia më e madhe e futbollit evropian, UEFA. Mabetex Prishtina ka pranuar donacion 12 topa të futsallit të finales së Ligës së Kampionëve të vitit 2020. Lajmi konfirmohet nga kryetari i klubit, Fatos Dili, në rrjetin social "Facebook". "Dje kam pranuar një dhuratë nga UEFA, e cila na ka dërguar topat për Klubin e Futsallit #MabetexPrishtina", ka shkruar Fatos Dili, i cili e ka bërë një punë të jashtëzakonshme në klubin kryeqytetas e për këtë fakt është shpërblyer ditë më parë edhe nga Komuna e Prishtinës me çmimin e



punëtorit sportiv të vitit. Ndryshe, Mabetex Prishtina është vlerësuar edhe si storje suksese për organizimin e mirë të ndeshjeve si vendës në garat evropiane.

Mabetexi në këtë edicion në garat evropiane e eliminoi në fillim Tiranën për t'u eliminuar më pas nga gjiganti spanjoll Barcelona në kuadër të Ligës së Kampionëve.

SHKURT

Zidane: Asgjë nuk ka përfunduar sa i përket kualifikimit

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, ka thënë se fitorja e ngushtë 1-0 e skuadrës së tij kundër Atalantës nuk nënkupton se madrilenët e kanë siguruar kualifikimin në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Ferland Mendy ia siguroi Real Madridit një fitore minimale në ndeshjen e parë të 1/8 së finales në udhëtim, kundër një Atalantës që luajti me 10 futbollistë nga minuta e 17-të. "Nuk prisja që ta kishim të lehtë, sepse ne e dinim se Atalanta është fizikisht shumë e fortë dhe ajo e dëshmoi këtë. E patëm të vështirë edhe kundër 10 futbollistëve, por e shënuam një gol të rëndësishëm. Por kjo nuk do të thotë asgjë, sepse e kemi edhe ndeshjen e kthimit dhe kjo bën që shanset të jenë 50-50", ka thënë Zidane.

Gjendet i vdekur në liqen babai i portierit të Liverpoolit

Një lajm i trishtë ka tronditur familjen e portierit të Liverpoolit, Alisson Becker. Babai i tij, Jose Agostinho Becker, ka ndërruar jetë në moshën 57-vjeçare në jug të Brazilit. Mediat vendase bëjnë me dije se ai është gjetur i vdekur në një liqen pranë shtëpisë së tij. Lajmi për ndarjen nga jeta të babait gardianit të Liverpoolit është konfirmuar edhe nga klubi i Sao Paulos nëpërmjet një njoftimi zyrtar në "Twitter". "Me shumë keqardhje ekipi i Sao Paulos merr lajmin e trishtuar për vdekjen e Jose Agostinho Becker, babait të portierëve Alisson dhe Muriel", shkruhet në njoftimin e klubit brazilian. Siç raportohet, 57-vjeçari ishte raportuar i zhdukur dhe vetëm pas disa orëve ai u gjet i vdekur në liqen.

Leonardo: Së shpejti vendoset e ardhmja e Mbappes dhe Neymarit

E ardhmja e Kylian Mbappes dhe Neymarit zë vendin e parë në çështjet për zgjidhje te PSG-ja. Drejtori sportiv, Leonardo, foli për këtë në intervistën e dhënë "France Bleu Paris" dhe raportuar nga "L'Equipe". "Kemi kohë që flasim për kontratën e Kylian Mbappes. Ka ardhur momenti për të marrë një vendim. Mund të them se ekziston një qasje e mirë për dialog", ka thënë Leonardo, i cili foli edhe për Neymarin. "Ne jemi në rrugën e duhur, por firma mbi kontratë do t'i japë fund gjithçkaje. Unë mendoj se është, gjithashtu, koha e duhur për rinovimet e Di Maria dhe Bernat. Ideja është t'i mbyllim këto katër rinovime sa më shpejt të jetë e mundur. Ne duam t'i mbajmë të gjithë", ka shtuar Leonardo.

Interi njofton për pesë të infektuar me Covid

Gjatë ditës së sotme përmes një komunikate për shtyp klubi i Interit ka njoftuar se janë infektuar drejtorët menaxhues Alessandro Antonello dhe Giuseppe Marotta. Drejtori Sportiv, Piero Ausilio, avokati i klubit Angelo Capellini dhe një anëtar i stafit teknik kanë dalë pozitivë me Covid-19. Deri tani nuk është njoftuar për ndonjë lojtar të prekur nga virusi. "Të gjithë menaxherët dhe i gjithë grupi i ekipit do t'i ndjekin procedurat e përcaktuara në protokollin shëndetësor", thuhet në njoftimin e Interit.

Roma vendos ta blejë kartonin e Mayoralit

Borja Mayoral është përshtatur me skemat e Fonseca dhe ndihet mjaft mirë te Roma me këtë të fundit që po mendon ta blejë përfundimisht kartonin e sulmuesit. 23-vjeçari u huazua nga Real Madridi për dy sezone dhe pas sezonit të parë ekziston klauzola që Roma mund ta blejë për 15 milionë euro lojtarin spanjoll. 10 gola e 6 asistime në 27 ndeshje që në vitin e parë në Serinë A nuk janë pak për Mayoral i cili ka edhe besimin e Fonseca dhe prej këtij të fundit varet gjithçka pasi qëndrimi i trajnerit do të konfirmonte edhe blerjen përfundimtare nga Reali.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kiesłowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kiesłowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kiesłowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kiesłowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



ISBN 978-9951-780-37-7

9 789951 780377




AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚŁOWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

「nga Moisiu deri te Kiesłowski」



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



ISBN 978-9951-780-10-0

9 789951 780100

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





NJOFTIM PËR KONTRATË

(Punë)

Tenderi

Procedurë e hapur

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (dhjetor 2016)"

I Numërtimi i Prokurimit: BQK 21 006 321
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK

II LËNDA E KONTRATËS

II.1.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja:

"Renovimi i hyrjes dhe zyreve protokollare të BQK-së"

III VENDI I REALIZIMIT

III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK, 10000 Prishtinë, Rr. "Garibaldi" nr. 33

IV KRITERI PËR DHËNIE TË KONTRATËS

IV.1 "Tenderi i përshatshëm ekonomikisht më i favorshëm" (për më tepër informata referojuni versionit të zgjeruar të njoftimit për kontratë publikuar në www.bqk-kos.org/shpallje/tenderet)

V INFORMATA ADMINISTRATIVE

V.1 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata tjera:

Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit: 12.03.2021 ora 14:00 në e-mail adresën prokurimi@bqk-kos.org

Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 11.03.2021 ora 14:00

V.2 Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve:

Data: 18.03.2021, ora 14:00

V.3 Sigurimi i tenderit: 8,000.00 Euro (me vlefshmëri 120 ditë, nga data e hapjes së ofertave).

V.4 Sigurimi i kontratës: 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditë më shumë se sa afati i realizimit.

V.5 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 18.03.2021, ora 14:30. Vendi: Auditoriumi i BQK-së, Rr. "Garibaldi" nr. 33

VI INFORMATA PLOTËSUESE

VI.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë në dispozicion në: www.bqk-kos.org

VII ANKESAT

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës", çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë BQK-së brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve kalendarikë nga shpallja e njoftimit përkatës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Garibaldi 33, 10000 Prishtinë

www.bqk-kos.org

Njoftojmë te gjithë klientët së "Master Lease LLC" më seli në Prishtinë, ka marre vendim të shuaje biznesin më numër: 601698915, numri unik identifikues 810869886 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kane raporte kreditore- debitorë që të paraqiten ne afatin kohor për 30 ditor nga data e shpalljes në gazete.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Senad Beqiri shpallë të pavlefshëm indeksin e Fakultetit të Mjekisë me numër 0279905.
- HavisheBehluli shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit të Mjekësisë në U.P. Drejtimi Farmacisë-Prishtinë.
- Qërim Nreci shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "ShtjefanGjeqovi" Prishtinë.
- Shpresa (Sabit)Sejdiu shpall të pavlefshme diplomën e Masterit (MA) në Kolegjit AAB drejtimi në politika sociale dhe mirëqenia e fëmijëve të Kolegjit AAB.
- Shpresa (Sabit)Sejdiu shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit drejtimi në Përkujdesje dhe Mirëqenia e Fëmijëve të Kolegjit AAB.
- Vedat Hajdari shpallë të pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".
- Kushtrim Hasani B.I shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 810554669.
- Florijan Zekaj shpallë të pavlefshme tri dëftesat SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- Melahat Karaqi shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- Mimoza Vrella shpallë të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

